

Hivzi Islami

## TRANSFORMIMET STRUKTURALE TË FAMILJEVE TË KOSOVËS

Kosova, meqë me shekuj është zhvilluar në kushte shumë të pavolitshme historike e politike, ekonomike, sociale dhe kulture, paraqet një hapësirë specifike. Si para lufte, ashtu edhe tash, ajo për nga të gjithë indikatorët socialo-ekonomikë dhe demografikë dallohet nga të gjitha viset e Jugosllavisë. Kujdes të veçantë paraqet sidomos situata e saj populative, ku për nga lëvizjet, strukturat dhe proceset demografike, si dhe asociacionet e tjera të popullsisë, sikurse janë familjet dhe vendbanimet, ajo hyn në radhën e regjioneve më interesante jo vetëm të ne, por edhe në botë.

Në Jugosllavi deri tash dihetin ekstremitetet demografike, Sllovenia në një anë, dhe Kosova, në anën tjetër. Mirëpo, viteve të fundit, rolin e Sllovenisë për nga shumë karakteristika të zhvillimit të popullsisë e muerën disa vise të tjera. Për shembull sot singularitet popullativ në Jugosllavi është Kroacia, dhe në disa elemente të popullsisë edhe Vojvodina. Ndërsa Kosova për nga të gjitha karakteristikat e zhvillimit të popullsisë ende mban vendin e parë në vendin tonë, madje me ndryshime bukur të thekësuar. Derisa viset e përmendura dhe të tjerat e kanë kaluar periudhën e transformimit demografik, respektivisht gjenden në nënetapën e vonë të tranzicionit demografik, Kosova gjendet në nënetapën e hershme të fazës kaluese demografike, në të cilën fertiliteti (nataliteti) është në një nivel shumë të lartë, ndërsa mortaliteti zbret në mënyrë rapide.<sup>1</sup>

Shkalla shumë e lartë e natalitetit (në dhjetëvjetëshin e fundit 39 deri 40 promila mesatarisht në vjet), rënja bruske e mortalitetit të përgjithshëm (prej më se 18 promileve në vitin 1950 në rreth 8 promile në vjet në vitin 1971) dhe veçanërisht e vdekjes së foshnjeve (prej më se 150 promileve në vitin 1950 në rreth 90 promile në vitin 1971), kanë shkaktuar rritje shumë të madhe natyrore (rreth 29 promile mesatarisht në vit gjatë decenjes së fundit). Ky shtim ekstrem natyror është edhe baza kryesore e eksplosionit demografik sot në Kosovë, i cili së bashku me elementet e tjera të zhvillimit demografik

<sup>1</sup> A. Wertheimer—Baletić, *Demografija* (Stanovništvo i ekonomski razvitak), Informator. Zagreb 1973, 105, 106.

dhe shoqëror-ekonomik, ka bërë riprodhimin jo të volitshëm të popullsisë. Gjithë periudhën e pasluftës e karakterizon shtimi ekspansiv i numrit të përgjithshëm të popullsisë, e veçanërisht në këtë drejtim dallohet periudha 1961—1971, kur bëhen transformime më të mëdha në dinamikën dhe në strukturën e zhvillimit shoqëror-ekonomik dhe demografik. Zhvillimi shoqëror dhe ekonomik, në këtë periudhë, karakteristikë përcjellëse e të cilit ishin procesi i industrializimit dhe i urbanizimit, meqë ishte jo i njëjtë, shkaktoi diferencime regjionale edhe në strukturën ekonomike dhe sociale edhe në zhvillimin demografik.<sup>2</sup>

Krahas me dinamikën demografike të Kosovës në periudhën e pasluftës dhe posaçërisht në periudhën në mes dy regjistrimeve të fundit, dhe me tempon e ndryshimeve strukturale të popullsisë, si dhe me ndryshimet e realizuara në sferën ekonomike dhe sociale dhe të shumë komponenteve të tjera të zhvillimit dhe të jetës shoqërore-ekonomike, ka ndryshuar edhe numri dhe struktura e familjeve.<sup>3</sup>

Në periudhën 1948—1971 numri i familjeve në Kosovë është rritur për 64%, ndërsa numri i popullsisë për të njëjtën periudhë për 70%. Kurse në periudhën 1961—1971, kur ndodhin ndryshime më të theksuara sociale, ekonomike, kulturele etj., popullsia rritet për 30%, ndërsa familjet për 23,3%.

Kjo do të thotë se lëvizja e numrit të familjeve, rritja e tyre, nuk e ka ndjekur rritjen e numrit të popullsisë. Ndërkaq, në viset e tjera të vendit indekset e zhvillimit të popullsisë dhe të familjeve nuk përputhen; numri i familjeve shënon një dinamikë më të shpejtuar. Si shembuj po përmendim Serbinë qendrore dhe Vojvodinën, si një ndër dy polet demografike sot në Jugosllavi. Në Serbinë qendrore numri i popullsisë në periudhën 1948—1971 është rritur për 29%, ndërsa numri i familjeve është rritur për 58%. Në periudhën 1961-1971 jazi është thelluar edhe më: popullsia është shtuar për 8,7%, kurse familjet për 19%. Në Vojvodinë gjithashtu është shënuar mospërputhja në mes të indeksit të lëvizjes së popullsisë dhe të familjeve. Në periudhën 1948-1971 numri i popullsisë është shtuar për 18,8%, ndërsa numri i familjeve për 35%, kurse në periudhën 1961—1971 numri i popullsisë është rritur për vetëm 5,1%, ndërsa i familjeve për 10%.<sup>4</sup>

<sup>2</sup> H. Islami, *Reperkusionet e lëvizjeve ekonomike dhe sociale në ndryshimet regjionale të zhvillimit demografik të Kosovës*, Përparimi, nr. 2—3, Prishtinë 1973, 95—115.

<sup>3</sup> Me termin *familje*, që është këtu objekt trajtimi, nënkuptohet familja si bashkësi ekonomike shtëpiake (serbisht *domaćinstvo*), si njësi e ndërlikuar statistike, me përmbajtje sociologjike-ekonomike. Ajo si e tillë definohet me mënyrën e jetesës (banimi, ekonomizimi dhe konsumimi i të ardhurave). Familja, pra, në statistikën jugosllave paraqet familjen në kuptim të ngushtë ose bashkësinë më të gjerë të personave, anëtarët e së cilës së bashku jetojnë në një shtëpi ose në një banesë dhe së bashku konsumojnë të ardhurat e veta të realizuara për plotësimin e nevojave themelore jetësore. Si familje në vete konsiderohet edhe çdo person që jeton vetëm dhe që të ardhurat e veta i konsumon vetëm, ndërsa ai grup personash që jeton nëpër ente të ndryshme sociale e të tjera (shtëpitë për të varfër, për pleq, për të verbër, të sëmurë nga smundjet e pashërueshme, shtëpitë e nxënësve, të dënuarëve, kazernat etj.) gjithashtu janë familje, por të ashtuquajtura familje kolektive.

Koncepti *familje* paraqet njësinë biologjiko-sociologjike, që krijohet në procesin e reproduktionit të popullsisë dhe bazohet në marrëdhënjet që në shoqëri janë të rregulluara me normat juridike ose zakonore. Dallohen disa lloje familjesh që njihen në statistikën demografike jugosllave. *Familja në kuptim të ngushtë* ose *familja e plotë* përbëhet nga çifti bashkëshortor dhe nga fëmijët e tyre, të cilët ende nuk kanë lidhur kurorë dhe jetojnë së bashku me prindërit. Në strukturën e *familjes në kuptim të gjerë* përveç çiftit bashkëshortor dhe fëmijëve të tyre, hyjnë edhe personat e tjerë të afërt. (Shih më gjerë: Višejezički demografski rečnik, Institut društvenih nauka, Centar za demografska istraživanja, Beograd 1971, dhe metodologjinë e regjistrimeve të vitit 1961 dhe 1971). Në Kosovë, dhe veçmas ndër shqiptarë, ekzistojnë të ashtuquajturat *familje të mëdha*, për të cilat ka shkruar gjerësisht Prof. Mark Krasniqi.

<sup>4</sup> Lj. Škara, *Poslednji demografski bilans SR Srbije*, Sociologija, časopis za sociologiju, socijalnu psihologiju i socijalnu antropologiju, nr. 2, Beograd 1971, 260, 265.

Ritmin e lëvizjes së familjeve më së miri e tregon madhësia mesatare e anëtarëve të familjes dhe përbërja sipas numrit të anëtarëve, e të gjitha varet e tjera të Jugosllavisë vërehet tendenca e zvoglimit, ndërsa në Kosovë edhe madhësia mesatare edhe përqindja e familjeve me nga 5 e më shumë anëtarë, është rritur. Madje, edhe në Maqedoni, e cila për nga shumë karakteristika sociale-ekonomike dhe demografike e të tjera është më afër Kosovës, është vërejtur procesi i zvoglimit të numrit të anëtarëve të familjeve (Tab. 1).

Tabela 1. Madhësia mesatare e familjeve sipas republikave dhe krahinave autonome, sipas regjistrimeve të pasluftës<sup>5</sup>

Hapësira	Numri mesatar i anëtarëve për familje			
	1948	1953	1961	1971
Jugosllavia	4,37	4,29	3,99	3,82
B e H	5,15	5,04	4,64	4,41
Mali i Zi	4,51	4,56	4,43	4,34
Kroacia	3,94	3,81	3,56	3,43
Maqedonia	5,27	5,30	5,02	4,68
Sllovenia	3,78	3,66	3,47	3,35
Sërbia qendrore	4,54	4,44	3,97	3,63
Vojvodina	3,61	3,50	3,31	3,18
Kosova	6,36	6,42	6,32	6,61

Ekzistojnë një mori faktorësh që ndikojnë në zvoglimin e madhësisë mesatare të familjeve, ndër të cilët dominantë janë ata të natyrës demografike (rënja e shkallës së natalitetit dhe të fertilitetit, shkalla e dukshme e divorcimit, mortaliteti etj.), ekonomike (transformimi i strukturës ekonomike të popullsisë, transferimi i popullsisë bujqësore në atë jobujqësore, copëtimi i parcelave etj.), sociologjike (ndryshimet në strukturën e familjes, si bashkësi sociologjiko-biologjiko-demografike), madje mobiliteti i thekësuar hapësiror i popullsisë, gjithashtu paraqet faktor me rëndësi në zvoglimin e vëllimit të familjeve, koncentrimi i popullsisë në qendra të qytetit dhe në ato industriale, niveli i lartë kultural, standardi jetësor etj. që do të thotë të gjitha elementet që ndikojnë në reproduksionin racional dhe human të popullsisë dhe, lidhur me të, në shumë elemente të tjera të zhvillimit të popullsisë.

Të gjithë faktorët e përmendur janë karakteristikë e viseve të zhvilluara në pikëpamje shoqërore-ekonomike dhe të atyre ku ambienti etnografik nuk është i ngarkuar me veçoritë e vjetra të jetës patriarkale, pra traditës, religjionit, dokeve etj. Në Kosovë, mjerisht, faktorët e përmendur kanë ende ndikim

<sup>5</sup> Popis stanovništva 1961, Knjiga XVI, Veličina i izvori prihoda domaćinstava, Rezultati za naselja, Beograd 1965, dhe Popis stanovništva i stanova 1971, Stanovništvo i domaćinstva po opštinama (Usporedni podaci 1961 i 1971), Pokrajinski zavod za statistiku, Priština 1973 (në shtyp).

në drejtim të kundërt. Prandaj, ndarja e familjeve dhe ndryshimet si në pikëpamje të numrit (madhësisë mesatare) ashtu edhe në pikëpamje të strukturës së tyre, përkundër depërtimit të botëkuptimeve dhe të proceseve bashkëkohore, që janë evidente kohëve të fundit me transformimet e përgjithshme shoqërore-ekonomike, kulturele dhe psikologjike, është dukuri e ngadalshme, ndërsa në viset e tjera, si u pa, ky proces është mjaft progresiv. Edhe në bazë të këtij shembulli të zhvillimit të këtyre grupeve shoqërore në Kosovë, mund të nxirret konkluzioni se ligjet e zhvillimit të popullsisë janë funksion i lëvizjeve shoqërore-ekonomike, por proceset demografike, meqenëse janë me karakter afatgjatë, gjithmonë relativisht vonë reagojnë në ndryshimet sociale-ekonomike. Prandaj, procesi i zvoglimit të madhësisë së këtij asociacioni të popullsisë, sikurse edhe fenomenet dhe proceset e tjera të zhvillimit demografik gjithmonë manifestohen më vonë.

Mirëpo, duhet thekësuar se madhësia e familjeve dhe shkatërrimi i ngadalshëm i tyre në Kosovë nuk është vetëm pasqyrim i dinamikës demografike (shkallës së lartë të natalitetit dhe të shtimit natyror), ndonëse kjo dinamikë, sikundër u pa më lart nga ekspansioni i numrit të popullsisë, është mjaft progresive, dhe i zhvillimit të ngadalshëm shoqëror-ekonomik të kësaj Krahine, por edhe i një morie faktorësh të tjerë, pikërisht karakteristikë për këtë trevë, me karakter historik, etnopsikologjik dhe ekonomik. Ndikimi i tyre shihet sidomos në ruajtjen e familjeve të mëdha të popullsisë shqiptare.<sup>6</sup> Kjo shihet nga përqindja e madhe e familjeve me nga 8 e më tepër anëtarë. Madje, çka është paradoksale, kjo pjesëmarrje në strukturën e familjeve, për shkak të kompleksit demografik, dhe socioekonomik, është rritur prej 28,7% në vitin 1961 në 31,9% më 1971 (Tab. 2).

Tabela 2. Struktura e familjeve të Jugosllavisë, Sërbisë qendrore dhe të Kosovës<sup>7</sup>

		Madhësia mesatare								8 e më tepër anëtarë
		1	2	3	4	Me nga		7		
						5	6			
Jugosllavia	1961	4,0	13,6	15,7	17,2	18,5	13,7	9,2	5,4	7,0
	1971	3,8	—	—	—	—	—	—	—	—
Sërbia qendrore	1961	4,0	13,1	14,8	16,8	19,2	14,3	10,2	5,5	5,9
	1971	3,6	—	—	—	—	—	—	—	—
Kosova	1961	6,3	6,4	7,2	8,9	11,9	13,2	12,2	10,9	28,7
	1971 <sup>8</sup>	6,6	4,7	6,8	8,9	11,9	12,2	12,5	11,1	31,9

Nga shënimet e parashtuara vërehet evolucioni krejt i kundërt i strukturës së familjeve në Kosovë nga ai në Jugosllavi dhe nga ai në Serbinë qendrore, ndonëse për këto, për vitin 1971, nuk ka të dhëna për ta krahasuar këtë ecuri

<sup>6</sup> M. Krasniçi, *Siptarska porodična zadruga u Kosovsko-Metohijskoj Oblasti*, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije, knj. IV—V (1959—1960), Priština 1960, 137—171.

<sup>7</sup> Popis stanovništva 1961, Knjiga XVI, Veličina i izvori prihoda domaćinstava Rezultati za naselja, SZS, Beograd 1965.

<sup>8</sup> Për Kosovën për vitin 1971: *Popis stanovništva i stanova 1971, Stanovništvo i domaćinstva po opštinama*, PZS, Priština 1973.

të përbërjes së familjeve. Mirëpo, në bazë të zvoglimit të madhësisë mesatare të Jugosllavisë dhe të Sërbisë qendrore është e sigurtë se përqindja me nga 1,2, 3 dhe 4 anëtarë është rritur, ndërsa pjesëmarrja e familjeve me nga 5 e më shumë anëtarë është zvogluar. Mospërshtatshmëria e këtij oscilimi të strukturës së familjeve në Kosovë qëndron veçanërisht në faktin se edhe më është zvogluar përqindja e familjeve me nga një dhe dy anëtarë, që është pasojë e shpërnguljes së një pjese të popullsisë joshqiptare në këtë periudhë me këtë strukturë, ndërsa përqindja e familjeve me nga 3, 4 dhe 5 anëtarë ka mbetur e njëjtë, kurse është rritur përqindja me nga 6,7,8 dhe më tepër anëtarë në vitin 1971. Ky proces i pavolitshëm, karakteristik për ambientet e pazhvilluara, agroblegtorale, është ligjësi që mund të shpjegohet lehtë për të gjitha periudhat e pasluftës, madje edhe për periudhën 1961-1971, për çka u bë fjalë më parë.

Sot duket se situata ekonomike, përveç faktorëve të tjerë me përmbajtje etnopsikologjike dhe patriarkale, është momenti vendimtar në ruajtjen e familjeve të mëdha në Kosovë. Kosova, siç dihet, është më tepër hapësirë agrare (para lufte rreth 90% të popullsisë ka qenë bujqësore, pas luftës gjithnjë është zvogluar pjesëmarrja relative e popullsisë bujqësore: më 1948 79,8%, më 1953 72,3%, më 1961 ka zbritur në 64,1%, ndërsa në vitin 1971 ka rënë në 52%<sup>9</sup>) me elemente të ekonomizimit natyral dhe gjysëm natyral, ekonomizim ky që përpara ka qenë shumë më i theksuar se sot. Familjet me shumë anëtarë kanë numër më të madh të fuqisë punëtore dhe dishiplinë më të fortë, numër më të madh të fakshëve, diçka më të pasur inventarin bujqësor, kanë parcela më të mëdha toke, ndërsa ndarja e punës është më e gjerë, etj. Gjithë kjo strukturë i përshtatet natyrës së kësaj mënyre të prodhimit. Prandaj, dhe për shkak të një numri të konsiderueshëm të personave të mbajtur — të fëmijëve, të nxënësve dhe të studentëve, të amviseve, të pleqve, të paaftëve për punë etj. (më 1961 përqindja e popullsisë së mbajtur<sup>10</sup> ishte 63,9%, ndërsa më 1971, për shkak të shkallës së lartë të fertilitetit të popullsisë, të emancipimit jo sa duhet të popullsisë, sidomos të pjesës femërore, që e zvoglon angazhimin e saj në veprimtaritë ekonomike dhe shoqërore, të rritjes së numrit të nxënësve dhe të studentëve në këtë periudhë etj, pjesëmarrja e popullsisë së mbajtur është rritur në 72,0%), së bashku me normat e veçanta patriarkale të jetës, familjet me shumë anëtarë nuk shkapërderdhen.

Familjet e mëdha në Kosovë, edhe pse zhduken me kohë, prapëseprapë janë ruajtur në numër të konsiderueshëm. Te shqiptarët deri vonë, madje edhe sot, ishte dukuri e rëndomtë që familjet të kenë nga 20 e më shumë anëtarë. Madje ka raste kur ky numër është edhe 30 e më tepër; në regjionin e Dukagjinit, në rrethinat e Pejës, të Gjakovës dhe të Prizrenit janë shënuar familje edhe me nga 50, e edhe 80 anëtarë.<sup>11</sup> Në këto bashkësi familjesh janë edhe kushtet më të volitshme për ruajtjen e mbeturinave të shumë elementeve patriarkale, dhe te ato vështirë krijohet psikologjia e jetës individuale.<sup>12</sup> Në këto

<sup>9</sup> Rezultate definitive të të gjitha regjistrimeve të popullsisë, Enti federativ dhe Enti krahinor i statistikës, Beograd dhe Prishtinë.

<sup>10</sup> Popullsinë e mbajtur e përbëjnë të gjithë ata që nuk kanë të ardhura të veta në asnjë bazë, por i mbajnë prindërit, të afërtit ose personat e tjerë.

<sup>11</sup> M. Krasniçi, *Siptarska porodična zadruga u Kosovsko-Metohijskoj Oblasti*, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije, knj. IV—V, Priština 1960.

<sup>12</sup> M. Krasniçi, *Urbanizacija naselja i stanovništva s posebnim osvrtom na Kosovu i Metohiju*, Zbornik Pravno-ekonomskog fakulteta, Tom V, Priština 1965, 24.

grupe të popullsisë, sot te një numër më i vogël, organizimi shoqëror dhe jeta shoqërore ende rregullohen sipas normave të Kanunit mesjetar të Lekë Dukagjinit, me shumë veti negative, por në të ka edhe karakteristika pozitive të së drejtës zakonore.<sup>13</sup>

Me zhvillimin dinamik të disa qendrave të qyteteve të Kosovës, të industrisë dhe të veprimtarive të tjera shoqërore, struktura e padiferencuar sociale dhe ekonomike u zbërthye, e me të edhe hapësira në shumë indikatorë socio-demografikë, ekonomikë dhe kulturale u diferencua në nivel të pjesës së Kosovës dhe të Dukagjinit, në nivel të komunave dhe të njësive më të vogla territoriale. Variacionet e reja së pari u paraqitën në zhvillimin shoqëror-ekonomik, ndërsa më vonë edhe në zhvillimin popullativ. Ndryshimet në nivel të komunave u manifestuan qartë edhe në madhësinë, në indeksin e shtimit dhe në përbërjen e familjeve, që shihet nga kjo pasqyrë:

Tabela 3. Numri, indeksi dhe madhësia mesatare e familjeve të Kosovës sipas komunave, sipas regjistrimeve<sup>14</sup>

Komuna	N u m r i				Indeksi 1961 1971	Numri mesatar i anëtarëve për familje			
	1948	1953	1961	1971		1948	1953	1961	1971
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1. Vitia	4.137	4.649	5.180	5.818	112,3	6,60	6,61	6,49	6,86
2. Vuçitërna	4.677	5.156	6.150	7.677	124,8	6,43	6,60	6,47	6,61
3. Gllgovci	2.204	2.402	2.752	3.395	123,4	7,69	7,68	8,01	8,64
4. Gilani	6.597	7.228	8.648	10.463	121,0	6,35	6,31	6,18	6,49
5. Deçani	2.797	2.912	3.386	3.795	112,1	7,40	7,63	7,56	8,26
6. Dragashi	3.184	3.345	3.342	3.811	114,0	6,32	6,02	6,29	7,04
7. Gjakova	6.454	6.846	8.210	10.020	122,0	6,20	6,49	6,49	7,12
8. Istogu	3.713	4.098	4.877	5.636	115,6	6,81	6,97	6,93	7,28
9. Kaçaniku	2.596	2.776	3.103	3.408	109,8	6,28	6,53	6,36	7,04
10. Klina	3.675	3.907	4.639	5.119	110,4	7,10	7,25	7,32	8,27
11. Kamenica	5.314	5.683	6.184	6.939	112,2	7,09	7,03	6,96	6,70
12. Mitrovica	9.236	10.506	13.173	16.890	128,2	5,27	5,43	5,36	5,38
13. Leposaviqi	2.109	2.452	3.165	3.761	118,8	7,04	6,90	5,97	4,80
14. Lipjani	4.834	5.348	6.267	7.526	120,1	6,40	6,45	6,39	6,56
15. Rahoveci	3.936	4.245	4.777	5.431	113,7	6,95	7,09	7,42	8,62
16. Peja	8.357	9.120	11.405	14.231	124,8	5,59	5,84	5,84	6,33
17. Podujeva	6.189	6.732	7.673	8.689	113,2	6,76	6,88	6,71	6,94
18. Prizreni	9.537	10.020	11.322	14.381	127,0	5,73	5,96	6,19	6,79
19. Prishtina	11.221	13.389	19.178	28.003	146,0	5,84	5,71	5,34	5,45
20. Sërbica	3.186	3.570	4.094	4.555	111,3	7,58	7,39	7,44	8,05
21. Suha Reka	3.695	4.188	4.620	5.219	113,0	7,32	7,21	7,52	8,68
22. Ferizaji	7.638	8.432	10.453	13.340	127,6	6,38	6,46	6,10	6,33
Kosova	115.283	127.004	152.598	188.107	123,3	6,36	6,42	6,32	6,61

<sup>13</sup> Për këtë shih: S. P u p o v c i, *Marrëdhënjet juridike civile në Kanunin e Lekë Dukagjinit*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore, Prishtinë 1969, dhe M. K r a s n i ç i, *O besë — prilog proučavanja običajnog prava kod Šiptara*, Zbornik za narodni život i običaje, knj. 40, JAZU, Zagreb 1962, 271—281.

<sup>14</sup> *Popis stanovništva i stanova 1971*, Stanovništvo i domaćinstva po opštinama, Konačni rezultati, PZS, Priština 1973.

Vërehet se numri absolut dhe relativ i familjeve në të gjitha komunat është rritur, në disa më shumë e në disa më pak, ndërsa indeksi i rritjes së tyre mbetet prapa indeksit të rritjes së popullsisë në periudhën 1961-1971. Përbërësit në pikëpamje të shtimit më të madh të numrit të familjeve nga ai i popullsisë bëjnë komuna e Leposaviqit dhe komuna e Kamenicës. Në të parën familjet janë shtuar për 18,8%, ndërsa popullsia, jo vetëm që nuk është shtuar, por edhe ka rënë për 4,4%, kurse në komunën e Kamenicës numri i popullsisë është shtuar për 8,0%, ndërsa numri i familjeve për 12,2%. Kjo mospërputhje e lëvizjes së popullsisë dhe të familjeve në këto dy komuna është në lidhje me ecurinë e fenomeneve demografike, natalitetin dhe shtimin natyror. Shkallët e të cilëve jo vetëm që janë më të ulëta, por kanë zbritur edhe më tepër. Në komunën e Leposaviqit, psh., shkalla e natalitetit ka rënë prej më se 35 promileve mesatarisht në vjet para vitit 1960 në afro 17 promile më 1971, ndërsa e shtimit natyror prej afro 25 në afro 10 promila në vitin 1971 (nataliteti për Kosovën para vitit 1960 ishte rreth 43 promila dhe më 1971 rreth 37 promila, ndërsa shtimi natyror rreth 26 promila para vitit 1960 dhe rreth 29 promila në vitin 1971). Në komunën e Kamenicës shkalla e natalitetit ka rënë prej më se 42 promileve para vitit 1960 në afro 30 promila në vitin 1971, ndërsa shkalla e shtimit natyror prej afro 27 promileve në afro 22 promila.

Në këto dy komuna edhe madhësia mesatare e familjeve është zvogluar, ndërsa te të gjitha komunat e tjera vërehet procesi i rritjes së madhësisë mesatare në periudhën 1961—1971, me përjashtim të disa komunave, ku kjo madhësi është zvogluar në periudhën 1948—1953 dhe 1953—1961, por prapë në periudhën 1961—1971 është rritur. E kjo është pasojë e imigrimeve të konsiderueshme të popullsisë në qendrat e këtyre komunave në këtë periudhë; për këto ardhje do të bëhet fjalë më vonë. Në komunat, ku numerikisht dominon popullsia shqiptare dhe në strukturën nacionale merr pjesë me më se 90%, madhësia mesatare e familjeve jo vetëm që ka shënuar ekspansion, por edhe është më e madhe, më se 8,5 anëtarë për familje (Glogovci, Deçani, Rahoveci, Sërbica, Suha Reka etj.). Në këto komuna edhe struktura e familjeve sipas numrit të anëtarëve, sikurse edhe veçoritë e tjera të zhvillimit socioekonomik dhe demografik, është mjaft karakteristike. Dhe, ritmi i procesit tregon jo vetëm diferencimin hapësinor dhe etnik, por edhe zhvillimin e ndryshëm kohor: në komunën e Leposaviqit është zvogluar përqindja me nga 6 dhe 7 anëtarë, kurse është rritur pjesëmarrja me 1,2,3,4 dhe 5 anëtarë. Në komunën e Kamenicës përqindja me 8 e më tepër anëtarë është zvogluar në vitin 1971, ndërsa në komunën e Mitrovicës dhe të Prishtinës pjesëmarrja me 8 e më tepër anëtarë është e njëjtë si në vitin 1961, ashtu edhe në vitin 1971. Përkundrazi në të gjitha komunat e tjera struktura ka ndryshuar në mënyrë jo të volitshme me rritje ekspansive të familjeve me më tepër se 8 anëtarë, ndërsa është zvogluar përqindja e familjeve me nga 1, 2, 3, 4 dhe 5 anëtarë. Domethënë, në këto komuna vërehet tendenca e ekspansionit të madhësisë së familjeve, ndërsa në komunën e Leposaviqit (më se 90% të popullsisë së kombësisë sërbe) dhe në të tjerat atomizimi. Krejt kjo është në pajtim me karakteristikat e përgjithshme të zhvillimit të popullsisë dhe me indikatorët e tjerë të zhvillimit shoqëror-ekonomik të këtyre komuneve.

Tabela 4. Struktura e familjeve sipas numrit të anëtarëve<sup>15</sup>

Komuna	Regjistrimi	Gjithsejt	Me nga								8 e më tepër anëtarë
			1	2	3	4	5	6	7		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
1. Vitia	1961	100,0	3,1	5,1	8,6	12,3	13,2	14,9	11,4	30,8	
	1971	100,0	2,5	5,8	6,9	10,2	12,3	13,5	13,2	35,0	
2. Vuçitërna	1961	100,0	4,8	5,7	8,3	12,3	12,1	13,9	11,8	31,0	
	1971	100,0	4,2	6,0	7,5	9,7	13,1	13,4	12,3	33,9	
3. Glllogovci	1961	100,0	3,3	3,7	5,5	8,5	10,6	11,3	12,4	44,6	
	1971	100,0	3,7	3,2	3,8	5,7	8,2	10,5	11,4	53,5	
4. Gilani	1961	100,0	5,6	6,8	8,7	11,8	13,9	12,8	12,0	28,4	
	1971	100,0	3,7	5,6	7,3	11,6	13,6	14,1	13,0	31,2	
5. Deçani	1961	100,0	4,9	7,4	8,2	10,2	12,2	11,1	8,8	37,2	
	1971	100,0	4,3	5,5	6,8	6,6	9,2	10,4	10,9	46,4	
6. Dragashi	1961	100,0	6,0	7,3	8,7	12,9	13,9	12,5	10,1	28,6	
	1971	100,0	4,2	6,2	6,8	11,4	13,3	12,1	10,8	35,2	
7. Gjakova	1961	100,0	6,5	9,2	9,2	11,8	11,7	11,9	10,6	29,0	
	1971	100,0	5,0	6,7	7,7	9,6	11,6	12,3	11,4	35,7	
8. Istogu	1961	100,0	6,0	7,3	7,8	10,4	11,2	12,2	10,8	34,3	
	1971	100,0	5,4	6,7	6,5	8,5	10,8	12,6	11,1	38,4	
9. Kaçaniku	1961	100,0	4,3	7,6	7,8	12,4	13,2	14,2	10,8	29,6	
	1971	100,0	2,9	6,7	6,6	8,1	10,9	12,8	13,5	39,3	
10. Klina	1961	100,0	4,9	6,1	7,4	10,7	10,5	12,7	11,8	36,6	
	1971	100,0	3,4	5,2	5,0	6,7	9,6	11,6	11,6	46,9	
11. Kamenica	1961	100,0	3,3	4,6	7,0	10,1	12,6	13,4	12,8	36,1	
	1971	100,0	3,0	5,0	6,9	10,8	13,8	14,0	13,4	33,1	
12. Mitrovica	1961	100,0	9,7	8,8	11,0	13,9	14,6	11,8	10,0	20,0	
	1971	100,0	6,6	9,3	10,5	16,6	14,9	12,5	9,5	20,1	
13. Leposaviqi	1961	100,0	9,7	4,7	7,7	10,8	14,6	14,6	11,3	26,6	
	1971	100,0	9,6	8,1	11,8	18,8	17,2	13,0	9,8	11,6	
14. Lipjani	1961	100,0	4,3	6,4	8,1	10,8	12,9	14,0	13,6	29,8	
	1971	100,0	3,9	6,4	6,5	10,9	12,1	13,6	13,6	33,4	
15. Rahoveci	1961	100,0	3,9	5,5	7,2	10,3	12,8	12,1	11,1	37,1	
	1971	100,0	3,4	4,0	5,1	7,0	10,1	11,1	11,7	47,5	
16. Peja	1961	100,0	7,7	10,4	11,1	12,4	13,2	11,8	9,7	23,6	
	1971	100,0	7,1	8,6	8,7	11,2	12,2	12,3	10,6	29,2	
17. Podujeva	1961	100,0	4,0	6,2	7,2	10,9	13,2	13,5	11,5	33,5	
	1971	100,0	3,9	6,1	6,6	9,7	11,4	12,2	12,0	38,0	
18. Prizreni	1961	100,0	6,4	7,7	9,8	12,0	14,0	13,1	10,7	26,4	
	1971	100,0	4,9	6,1	8,0	11,2	13,5	13,2	11,6	31,5	
19. Prishtina	1961	100,0	11,4	8,7	10,7	14,3	13,8	11,7	9,1	20,3	
	1971	100,0	6,4	8,4	10,8	17,8	14,8	11,8	9,4	20,6	
20. Sërbica	1961	100,0	4,2	5,4	7,1	8,9	11,4	11,6	11,3	40,2	
	1971	100,0	3,4	4,2	5,3	6,5	9,7	11,4	11,6	47,8	

<sup>15</sup> Po aty.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
21. Suha Reka	1961	100,0	4,5	4,4	6,5	9,5	11,9	12,6	11,4	39,3
	1971	100,0	3,1	3,7	4,5	6,5	9,0	11,1	11,5	50,5
22. Ferizaji	1961	100,0	4,0	7,0	9,2	13,2	15,2	14,6	11,3	25,5
	1971	100,0	3,9	6,4	7,7	12,4	14,3	13,6	12,0	29,7
Kosova	1961	100,0	6,4	7,2	9,0	12,0	13,2	12,8	10,9	28,6
	1971	100,0	4,9	6,7	8,0	11,9	12,8	12,5	11,3	31,9

Ndikimi i procesit të industrializimit dhe të urbanizimit, si dhe zhvillimi kultural dhe standardi jetësor, sikurse edhe te veçoritë dhe proceset e tjera të zhvillimit të popullsisë, është i paevitueshëm edhe te struktura e familjeve dhe madhësia e tyre mesatare. Në Kosovë, ky ndikim mund të vërtetohet në shembujt e vendbanimeve të qyteteve. Më parë treguam gjendjen për Krahinë dhe për komunat e saj, tash po e paraqesim vetëm për 7 qytete, qendra të forta të zhvillimit shoqëror-ekonomik dhe kultural, ku janë të përqendruar më se 80% të veprimtarive ekonomike dhe shoqërore dhe afro 21,5% të popullsisë së Krahinës, e 27,4% të numrit të përgjithshëm të familjeve të Kosovës në vitin 1971. Pra, përqindja e numrit të familjeve është më e madhe se përqindja e numrit të popullsisë në këto qytete.

Madhësia mesatare e familjeve në vendbanimet e qyteteve të Kosovës është më e madhe jo vetëm ndër vendbanimet e qyteteve të viseve të tjera të vendit tonë, por edhe të fshatrave, ndryshimi i të cilave në vitin 1961 ka qenë mjaft i madh.<sup>16</sup> Këto ndryshime, edhe pse nuk kemi të dhëna për t'i krahasuar, është e sigurtë se kanë mbetur edhe më vonë.<sup>17</sup> Mirëpo, prapë është shumë me rëndësi se edhe te popullsia e qyteteve të Kosovës, në kushtet e reja të punës dhe të jetës, ndryshohen përbërja e brendshme e familjeve e madhësia e tyre dhe gradualisht zhvillohet afiniteti për jetë individuale.

Tabela 5. Madhësia mesatare dhe struktura e familjeve të shtatë qendrave të qyteteve të Kosovës më 1971<sup>18</sup>

Qendra e qytetit	Madhësia mesatare		Me nga							8 e më tepër anëtarë
	1961	1971	1	2	3	4	5	6	7	
Gilani	4,6	5,2	6,9	8,2	11,1	17,4	16,3	13,7	10,6	15,1
Gjakova	5,2	5,6	6,0	8,1	9,6	10,3	13,6	14,1	12,5	23,3
Mitrovica	4,3	4,8	7,3	10,5	12,1	18,6	15,0	13,1	8,5	15,2
Peja	4,8	5,1	8,8	10,4	10,5	14,4	14,1	12,5	9,9	19,1
Prishtina	4,1	4,6	9,0	11,0	13,4	20,7	15,0	10,5	7,6	12,8
Prizreni	4,9	5,4	6,5	7,7	10,7	14,8	16,6	14,0	11,0	18,7
Ferizaji	4,9	5,4	5,5	7,8	10,0	16,3	16,3	13,2	10,7	20,2

<sup>16</sup> I. Ginić, *Dinamika i struktura građskog stanovništva Jugoslavije, Demografski aspekt urbanizacije*, Institut društvenih nauka, Centar za demografska istraživanja, Beograd 1967, 159.

<sup>17</sup> Në disa vise të Jugosllavisë p.sh. në Kroaci, hulumtimet tregojnë se te popullsia bujqësore dhe e fshatit shkalla e natalitetit është më e ulët se e popullsisë jobujqësore dhe asaj të qytetit (M. Rendulić, *Demografska kretanja u Hrvatskoj*, Naše teme, nr. 6, Zagreb 1965, 824—826).

<sup>18</sup> *Popis stanovništva 1971, Konačni podaci, Rezultati po opštinama*, Savezni zavod za statistiku, Beograd 1972.

Madhësia mesatare e familjeve, siç po shihet, në të gjitha qendrat është rritur, diku më pak e diku më shumë. Kjo është pasojë e imigrimeve të dukshme në periudhën e zhvillimit intensiv shoqëroro-ekonomik, 1961—1971, bartësit e të cilit janë pikërisht këto qytete. Ato krijuan edhe diferenca të reja të zhvillimit regional të popullsisë së Kosovës, si funksion i lëvizjeve sociale-ekonomike.<sup>19</sup> Për këtë shkak edhe procesi i lëvizjeve migrative u bë intensiv, sidomos në drejtim të qyteteve të përmendura dhe të tjerave. Fshatrat, meqenëse ngelën larg prapa qyteteve në pikëpamje të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, dhanë një numër bukur të madh emigruesish. Gati të njëjtën përqindje të emigrimit fshati i Kosovës e mbajti edhe në vitin 1971 (në vitin 1961 85,1%, ndërsa në vitin 1971 86,6% të ardhësve ishin nga fshati). Vendbanimet e qyteteve, ato të përziera dhe qendrat e tjera komunale, absorbuan në periudhën 1961—1971 më tepër se gjysmën e popullsisë së ardhur në to (58,1%), dhe intensiteti i imigrimeve prej vitit në vit u rrit, për çka më së miri dëshmojnë dy vitet e fundit të regjistrimit, viti 1970 dhe 1971. Numri i të ardhurve në këto dy vite është 15.000 persona ose 10% nga numri i përgjithshëm i të ardhurve në periudhën 1961—1971. Kjo popullsi e ardhur në periudhën në mes të dy regjistrimeve të fundit përbën me se gjysmën e popullsisë së qyteteve dhe më se gjysmën e numrit të përgjithshëm të popullsisë së ardhur të Krahinës. Më tepër popullsi, u muar vesh, kanë absorbuar qendrat urbano-industriale dhe administrative e kulturele. Në Prishtinë, psh., vetëm në periudhën 1961—1971 kanë ardhur rreth 15% të popullsisë së përgjithshme të ardhur në qytete, në Mitrovicë afro 7,5, në Prizren afro 6%, në Gilan dhe Ferizaj afro 6% të numrit të përgjithshëm të imigruesve.

Të ardhurit nga fshatrat jo vetëm që sollën me vete një numër të madh fëmijësh, por ata ishin në pikëpamje biodinamike shumë vitalë, në moshë të re, ende pa u liruar nga ambienti etnografik patriarkal — nga doket e ndryshme, normat morale, doktrinën, religjioni, tradita etj., krejt kjo le mbresa negative si në zhvillimin demografik — në planifikimin e familjes dhe të kontrollimit të lindjes etj., ashtu edhe në zhvillimin social, ekonomik, kultural, në përmbajtjen psikologjike etj.

Edhe në mesataren e numrit të anëtarëve të familjeve, menjëherë dallohen dy qendrat më të zhvilluara të qyteteve, Prishtina dhe Mitrovica, të cilat absorbojnë gati gjysmën e të inkuadruarëve në Krahinë (42%) dhe në strukturën e ekonomisë së Kosovës marrin pjesë me afro 43%. Sipas madhësisë mesatare, këto dy qytete janë diçka më afër Jugosllavisë dhe Sërbisë qendrore, ndërsa për dy anëtarë më poshtë se mesatarja e Krahinës, kurse për një herë më pak se komuna e Glogovcit, Deçanit, Rahovecit, Sërbicës, Suha Rekës, Klinës etj. Më tepër ka familje me nga 4 dhe 5 anëtarë, ndërsa me nga 8 e më tepër anëtarë për gjysëm më pak se mesatarja e Kosovës. Familje me nga një anëtar ka më tepër Prishtina (9,0%), Peja (8,8%) Mitrovica (7,3%). Kjo për arsye se në to migracionet prej fshatit kanë qenë më të mëdha dhe pse struktura ekonomike e popullsisë së tyre është më e volitshme dhe shkalla e arësimimit është në nivel më të lartë. Këto dhe qendrat e tjera kanë bërë që edhe

<sup>19</sup> H. I s l a m i, *Regionalne osobenosti razvoja stanovništva Kosova u razdoblju 1961—1971. g. kao funkcija socijalno-ekonomskih kretanja*, Referat i mbajtur në Simpoziumin jugosllav mbi popullsinë në Ohër në prill të vitit 1973.

komunat e tyre ta kenë përbërjen krejt tjetër nga ajo e komunave të tjera. Edhe te vendbanimet e tjera të qyteteve situata është shumë më e volitshme se mesatarja e Krahinës, dhe, çka është pozitive, vërehet tendenca e mëtejme e përmirësimit të strukturës së familjeve dhe të madhësisë së tyre.

Në saje të lëvizjeve bashkëkohore shoqërore-ekonomike në periudhën 1961—1971 janë bërë ndryshime të rëndësishme në strukturën sociale-ekonomike të popullsisë. U muarr vesh, ndryshime u bënë edhe në strukturën e të ardhurave, nga të clat familjet sigurojnë burimet e ekzistencës së vet jetësore. Për 6,6% ka rënë përqindja e familjeve bujqësore, për 8,6% e atyre me burime të përziera, ndërsa pjesëmarrja e familjeve jobujqësore është rritur veçanërisht, për 17,6%.

Tabela 6. Përqindja e familjeve me burime të të ardhurave bujqësore, të përziera dhe të atyre jobujqësore më 1961 dhe 1971<sup>20</sup>

Hapësira	Regjistrimi	F a m i l j e t		
		Bujqësore	Të përziera	Jobujqësore
Jugosllavia	1961	34,9	21,7	43,4
	1971	—	—	—
Sërbia qendrore	1961	39,3	18,1	42,3
	1971	—	—	—
Sllovenia	1961	20,3	19,2	60,5
	1971	—	—	—
Kosova	1961	43,7	24,9	31,4
	1971	37,7	16,3	49,0

Rënja e familjeve me burime nga bujqësia është e kuptueshme. Mirëpo, është interesant se bie përqindja e familjeve të kategorisë së përzier. Meqenëse ekzistimi i tyre është ligjësi e domosdoshme në fazën kaluese të zhvillimit shoqëror-ekonomik,<sup>21</sup> në të cilën gjendet tash pikërisht Kosova, është dashur të pritët rritja e kësaj kategorie të familjeve. Mirëpo, faktori demografik e struktura pronësore, respektivisht copëzimi bukur i thekësuar i parcelave tokësore, të ardhurat e vogla për një anëtar të familjes, mosha, përbërja socio-profesionale dhe arësimore e të zotit të shtëpisë, distanca në mes të fshatit dhe të qytetit, që, për shkak të disperzitetit të thekësuar, është bukur e madhe, mandej lidhjet jo të mira komunikative, shtytjet sociale-psikologjike (dëshira për të jetuar në qytet), numri i të inkuadruarve jashtë bujqësisë etj., shkaktojnë procesin e zvoglimit të familjeve bujqësore dhe të përziera. Për këto arsye këto familje e lanë bujqësinë dhe fshatin dhe kaluan në veprimtari jobujqësore dhe në qytet, gjë të cilën tregon më së miri rritja e numrit të popullsisë së vendbanimeve të qyteteve.

<sup>20</sup> *Popis stanovništva 1961*, Knjiga XVI, Veličina i izvori prihoda domaćinstava, Rezultati za naselja, Beograd 1965. Për Kosovën për vitin 1971: *Popis stanovništva i stanova 1971*, Stanovništvo i domaćinstva po opštinama, Konačni rezultati, PZS, Priština 1973.

<sup>21</sup> S. L i v a d a, *Mješovita gospodarstva u Jugoslaviji*, Sociologija sela, nr. 7—8, Agrarni institut, Zagreb 1965, 25.

Ekzistimi i familjeve të përziera në fazën e tashme të zhvillimit shoqëror-ekonomik dhe kultural është gjë shumë pozitive, në një anë, për shkak të strukturës jo të mirë socioprofesionale të popullsisë dhe të fuqisë punëtore (popullsisë aktive) dhe, në anën tjetër, pse kjo kategori e familjeve e zërthen gradualisht strukturën relativisht homogjene të fshatit në shumë aspekte dhe e nxit depërtimin e elementeve bashkëkohore në fshat. Këto ndikime manifestohen nëpërmjet procesit të migracioneve ditore të fuqisë punëtore, të cilin proces e shkaktojnë pikërisht familjet e përziera. Edhe kalimi drejtpërdrejt në qytet dhe në veprimtari jobujqësore, pa hyrë më parë në procesin e migracioneve ditore të fuqisë punëtore, e ngadalëson urbanizimin e plotë të jetës së të ardhurve në qytet, sepse të ardhurit nga fshati sjellin me vete doket e jetës fshatare me karakteristika të thekësuar patriarkale, ngadalësojnë procesin e lirimit nga tradita, të formuar me shekuj etj. Reperkusionet e tyre janë evidente në zhvillimin demografik dhe sociokultural.

*Hivzi Islami*

#### TRANSFORMATIONS STRUCTURALES DE L'ECONOMIE DOMESTIQUE DU KOSOVO

##### R é s u m é

Le Kosovo est connu, en Yougoslavie, comme une région dont le développement socio-économique et démographique est particulier. La complexité d'une telle situation est due aux circonstances spécifiques socio-historiques et politiques du passé, ainsi qu'à un très bas niveau de développement dans les plans socio-économiques, sanitaire, médical et culturel. Sa situation démographique provoque une attention particulière, soulignée surtout en ce qui concerne les mouvements, les structures et les procès démographiques, ainsi que les autres associations de la population — la famille, l'économie domestique et les localités.

Etant donné qu'il se situe à une époque démographique en pleine explosion, c. -à -d. en sous étape de haute transition démographique, il est compréhensible que la reproduction de la population ne soit pas en rapport avec l'économie. Le pourcentage très élevé de la natalité, suivi de la brusque diminution de la mortalité, surtout des nouveaux-nés, a conditionné une natalité naturelle très élevée (vers 29% en moyenne par an durant la dernière décennie), ce qui est la base principale de la récente explosion démographique de cette région. Toute la période d'après-guerre est caractérisée par une natalité totale expansive de la population, surtout par la période 1961-1971, où surviennent les changements de développement socio-économiques relativement les plus élevés, et en étroite liaison avec les transformations dans les migrations de la population et les structures.

Parallèlement à ces migrations dynamiques et structurales de la population et aux changements réalisés dans le domaine de l'économie, dans les services sociaux, éducatifs, culturels, etc; le nombre et la structure des économies domestiques changeaient.

Il est., important de signaler qu'on a noté au Kosovo une disproportion entre l'index du nombre des habitants et celui du développement des économies domestiques, par un progrès considérable du nombre des habitants. Ce procès est tout à fait différent de la Serbie et la Voïvodine. Tandis que dans toutes les autres régions en Yougoslavie le nombre moyen des membres d'une famille a diminué, au Kosovo il a augmenté, passant de 6,36 en 1948 à 6,32 en 1961 et à 6,61 en 1971.

Outre les faits démographiques, ralentissement du pourcentage de la natalité (fertilité), diminution brusque du pourcentage de la mortalité, en général, surtout celle des nouveaux-nés, un moindre pourcentage de divorces, il existe encore tout un ensemble de faits qui conditionnent un plus grand nombre moyen de familles avec l'augmentation de ce nombre en

1971. Surtout les faits de nature économique sont exprimées (structure économique défavorable de la population, fragmentation très nette des terres, transfert ralenti de la population agricole dans des activités non agricoles, etc.) et sociologique (changements ralentis dans la structure familiale des économies domestiques), puis migrations moins évidentes de la population, niveau très élevé de la densité dispersée, moindre concentration de la population dans les centres citadins et industriels, niveau culturel plus bas et, en général, du niveau de vie de la population, etc. Si l'on ajoute encore à ceci les autres faits de nature historique et ethno-psychologique, c'est donc un milieu surchargé de normes particulièrement patriarcales de la vie (traditions, religions, moeurs), alors on comprend la grandeur de la composition de ces économies domestiques. Il faut citer surtout le facteur économique dans le maintien de ces plus grandes associations de la population, ainsi dites coopératives familiales (familles dans le sens plus large et communautés de parenté). Puisque le Kosovo est une région agraire avec des éléments d'économie naturelle et semi-naturelle, alors la structure économique elle-même convient aux économies domestiques avec un plus grand nombre de membres. A savoir, ces économies domestiques, qui ont un plus grand prestige social dans leur milieu, ont une main-d'oeuvre plus nombreuse avec une meilleure discipline de travail, un plus grand nombre de têtes de bétail, un riche matériel agricole; les terres sont plus grandes et le partage du travail est un peu plus large. Le nombre des membres de ces familles atteint le chiffre de 20 à 30 et même davantage, tandis qu'auparavant il était de plus de 50 et même de 80 membres.

Cependant il est positif que sous l'influence du développement de l'industrialisation et l'urbanisation qui, au Kosovo, est poussée le plus dans villes, la grandeur moyenne et la composition interne des familles changent graduellement, pour avoir tendance à l'égalisation dans le nombre des familles et des économies domestiques. Ainsi, p. ex., dans les sept plus grands centres de la Région, dans lesquels sont concentrées à peu près 80% des activités économiques et sociales du Kosovo — non seulement la quantité moyenne est plus petite, mais la structure des économies domestiques est essentiellement différente. C'est-à-dire que le nombre des économies domestiques à 1,2,3, et 4 membres est encore plus important, tandis que les nombres plus élevés ont diminué.

Dans le période de 1961 à 1971 de considérables changements ont eu lieu dans la structure des revenus des ménages. La part des économies domestiques non agricoles a augmenté de 18%, tandis que la part de celles agricoles a diminué de 7% et la part de celles mixtes est à peu près de 9%.

